



SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 30.07.2015 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. ZYRTAR I NDIHMËS SOCIALE

Drejtoria: Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

Njësia –Qendra për punë sociale

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti aktual 5.5.

Numri i referencës së vendit të punës: 03-112-21751/15

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Procesimi i aplikacioneve të palëve që aplikojnë për ndihma sociale dhe verifikimi i informacioneve të dhëna me kriteret e pranimit,
2. Shpjegimi i kriterëve dhe procedurave aplikantëve dhe lëshimi i fletëaplikacioneve palëve të interesuara;
3. Është përgjegjës që të pranohen vetëm aplikacionet e e plotësuara në tërësi të shoqëruara me të gjitha dokumentet e nevojshme;
4. Është përgjegjës për futjen e informacioneve të aplikantit në bazë e të dhënave , dhe llogaritja e saktë e ndihmës për familje në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj;
5. Shqyrtimi i aplikacioneve me kohë dhe marrja e vendimeve në bazë kriterëve që I pëcakton ligji mbi S.A.S (skemën e asistencës sociale),
6. Mbajtja e sistemit efikas të dosjeve(sipas rendit alfabetik apo numrit), përgatitja dhe dërgimi i aplikantëve në komision mjekësor;
7. Informimi i palëve për dokumentacion shtesë,të reja dhe futja e tyre në dosje;
8. kryen edhe punë tjera relevante për QPS-në.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Përgatitje universitare- Baçelor i sociologjise
- Dy vite përvojë pune
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët .
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat te caktuar

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores -**Zyra e pranimit**, kati përddhesë dhe ne web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës

pen Besim Ilazi

